



### *VENDIM*

*Nr. 19 Datë 21.03.2014*

### PËR

### **FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “ENREL HYDRO” SH.P.K NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pika 1, gërma “d” të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “g”; 8 dhe 10 pika 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 21.03.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “EnRel Hydro” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie,

#### **Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “EnRel Hydro” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar pjesërisht: janë plotësuar gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, dhe , eshte pa plotësuar germa “e” (Struktura e ndertimit dhe funksionimit administrativ te shoqerise).

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10) është plotësuar pjesërisht : janë pa plotësuar gërmat “a” dhe “b” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar, kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e aktivitetit).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me pikat e sipërcituara, do të kërkohej subjektit të depozitohet në ERE brenda afateve të përcaktuara në Rregulloren për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/pjesëshëm dhe Rinovimit të Liçensave.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “EnRel Hydro” sh.p.k, për liçensim në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.